



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.82

Prishtinë, më 25.6.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204.

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Adriana Matoshi, Eliza Hoxha, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj, Arjeta Fejza dhe Vlora Dumoshi

Munguan: Albena Reshitaj, Enis Kervan, Ardian Kastrati.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri.

Mbledhjen e kryesoi: Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.05.2024;
3. Shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të KKTK;
4. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.5.2024

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 28.5.2024, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të KKTK;

Ardian Gola, tha se konkursi për zgjedhjen e 7 (shtatë) anëtarëve në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë (KKTK), sipas nenit 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë për një mandat 3 (tre) vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, është mbyllur në afatin e lejuar ligjor. Në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejt gjashtëmbëdhjetë kandidatë, para se të fillohet me intervistimin e kandidatëve kërkoi nga stafi mbështetës i Komisionit verifikimin e profesionit dhe përvojës së kandidatëve si dhe të diskutohet mundësia e formulimit të poentimit të kandidatëve.

Jahja Kokaj tha se nëse shiqojmë mundësinë e rritjes së formulës gjatë poentimit të kandidatëve duhet pasur parasysh përvojën e kandidatëve në fushën e trashëgimisë.

Eliza Hoxha tha se pasi kemi të bëjmë me një Këshill të rëndësishëm të veçantë si Komision të shiqojmë mundësinë e formulës së përqindjes për kandidatët që intervistohen duke pasur parasysh kriteret e përzgjedhjes si intergriteti profesioni dhe përvoja e kandidatëve.

Arijeta Rexhepi, kërkoi që të procedohen të dhënat e secilit prej kandidatëve, të caktohet data e intervistimit e më pas të bëhet poentimi gjithashtu tha se përvoja është me rëndësi të veçantë.

Ardian Gola lidhur me këtë tha se pasi se ti kemi të dhënat për verifikimin e profesionit dhe përvojës së kandidatëve për secilin kandidat, Komisioni do të caktoj datën e intervistimit dhe përzgjedhjen e tyre.

4. Të ndryshme

Për këtë pikë nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Ardian Gola,

Kryetar i Komisionit